



6.8 PARAMETRAT E KUJTESËS SË FRAGMENTEVE

Hapësiren e punës në ndërfaqen për katalogim mund ta ndryshoni sa herë që dëshironi.

Parametrat e paracaktuara të hapësirës së punës ndajnë dritaren e ndërfaqes në dy pjesë: në të majtë ndodhet redaktuesi, ndërsa në të djathtë kujtesa e fragmenteve e regjistrimeve. Nëse dëshironi të ndryshoni hapësirën e punës, në atë mënyrë që kujtesa e fragmenteve e regjistrimeve të jetë në anën e majtë, ndërsa redaktuesi në të djathtë, përdorni metodën **Parametrat / Ndërro paraqitjen**.

Nëse dëshironi të keni vetëm nëndritaren e majtë, në skajin lëvizës, i cili përcakton kufijtë e nëndritareve, klikoni ikonën  (shigjeta e kthyer në të djathtë). Nëse klikoni ikonën  (shigjeta e kthyer në të majtë), mbetet e hapur vetëm nëndritarja e djathtë.

Nëse dëshironi që në regjistrimin, të cilin po e krijoni ose po e redaktoni dhe i cili ndodhet në kujtesën e fragmenteve, të shfaqet përmbajtja e fushës apo nënfushës së përzgjedhur me ngjyrë blu, në menunë **Parametrat** duhet të klikoni kutinë e zgjedhjes "Shfaq fushën/nënfushën e përzgjedhur".

Çdo shënim ose ndryshim që bëni në redaktues, në kujtesën e fragmenteve nënvizohet me ngjyrë **të verdhë**.

Nëse dëshironi që në kujtesën e fragmenteve të regjistrimeve të shfaqen fushat 996, 997 dhe 998, në menunë **Parametrat** klikoni kutinë e zgjedhjes "Shfaq koleksionet e bibliotekës".